

Newsletter Nëntor 2019



Tërmeti që tronditi dhe na bashkoi për t'u ringritur sërish!

Ndërsa përgatitej të festonte festat e Pavarësisë dhe Çlirimit, Shqipëria u zgjua e tronditur mëngjesin e së martës së 26 nëntorit kur një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës Rihter me epiqendër në detin Adriatik lëkundti të gjithë vendin. 98 persona e gjetën veten nën rrënoja pas tërmetit, prej të cilëve 47 u nxorrën gjallë nga forcat e emergjencës që në orët e para pas goditjes, ndërsa 51 fatkeqësisht nuk ia dolën dot. Rreth 900 persona mbetën të plagosur. Qarqet më të dëmtuara ishin Durrësi, Tirana dhe Lezha. Dëmet në ndërtesa, shtëpi dhe godina shërbimesh janë ende duke u vlerësuar.

“Të ecësh me një mik përmes errësirës është më mirë se të ecësh i vetëm në dritë”, thotë një shprehje e vjetër. Në këto ditë errësire Shqipëria nuk mbeti vetëm. Solidariteti erdhi nga të gjitha anët. Flamuj kombesh nëpër uniformat e skuadrave të ndihmës së parë nga vendet fqinje dhe nga vende mike në Evropë e më gjerë u bënë bashkë me flamurin shqiptar në një betejë për jetën. Mesazhe solidariteti nga ndeshje futbolli dhe aktivitete kulturore erdhën nga të gjitha anët e globit si rreze shprese për të gjithë shqiptarët.

Rimëkëmbja nuk do të jetë e lehtë, por së bashku do ia dalim. Këtë fatkeqësi natyrore mund ta shndërrojmë në një mundësi, në një shans për të rregulluar atë çfarë është bërë gabim, për të menduar zhvillimin aty ku duam të jemi, jo aty ku ishim. Tërmeti i 26 nëntorit do të mbetet gjatë në memorien tonë shoqërore si një ngjarje që na goditi, na lëkundti, na dëmtoi, por nuk na vrau forcën, dëshirën dhe besimin se bashkë mund të ringrihem. Bashkë mund t'ia dalim!

Pranë banorëve për sigurinë e jetës dhe kapërcimin e emergjencës

“Ka shumë pasiguri. Edhe në objektet që janë shumë pak të dëmtuara banorët kërkojnë që të kryhet inspektimi për t’i dhënë njëfarë garancie apo sigurie. Jemi munduar të bëjmë shpjegime lidhur me shkallën e dëmtimit në rast se objekti është i banueshëm. Çfarë duhet të bëjnë, çfarë duhet të kenë kujdes,” thotë Elton Kallabaku, pjesë e trupës së inxhinierëve që Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka dërguar në terren që në orët e para pas tërmetit. Në shumë raste përveç inxhinierit i është dashur të bëjë edhe psikologun.



Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2019/12/01/prane-banoreve-per-sigurine-e-jetes-dhe-kapercimin-e-emergjences/>

Pas vështirësisë vjen lehtësimi

Të reja nga projektet

Pasojat e fatkeqësive natyrore dhe menaxhimi i procesit të rimëkëmbjes ka një impakt të drejtpërdrejtë në jetët e qytetarëve dhe mund të ndryshojnë të ardhmen e një rajoni përgjithmonë. Në historinë moderne ka pasur shumë raste kur tërmetet apo fatkeqësi të ngjashme natyrore kanë shërbyer për të ndryshuar thelbësisht modelin e zhvillimit në zonat e prekura.

Rindërtimi ofron mundësinë e zgjidhjes së problemeve, që kanë ekzistuar për një kohë të gjatë: përmirësimi i standardeve të ndërtimit, rinovimi i infrastrukturës, krijimi i mënyrave të reja të përdorimit të hapësirave, ripërtëritja e ekonomisë dhe përmirësimi i qeverisjes. Komiteti i Rindërtimit që u ngrit menjëherë pas tërmetit do të mbikqyrë hartimin e programit të rindërtimit që do të fokusohet në ringritjen dhe zhvillimin social, rigjallërimin ekonomik, ringritjen institucionale dhe rimëkëmbjen urbane dhe mjedisore.

Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2019/11/30/pas-veshtiresise-vjen-lehtesimi/>

Dhuro në ndihmë të banorëve të prekur nga tërmeti:
<https://e-albania.al/donate/>



54,020,905 lekë dhuruar online deri tani nga 5300 donatorë
Shuma e mësipërme përfaqëson vetëm kontributin e dhuruar online përmes kartave të debitit/kreditit.

Kush është i informuar është i shpëtuar

A e dini se?

- **Ulu:** Kur fillojnë lëkundjet uluni në gjunjë, për të parandaluar përplasjen në lëvizje e sipër. Kjo do t’ju japë mundësinë të zvarriteni poshtë një objekti për t’u mbrojtur.
- **Mbulohu:** Vendosni duart mbi kokë që të mbroheni nga sende të forta. Shkoni pranë një strehe dhe qëndroni larg mobiljeve që mund të rrëzohen.

Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2019/11/28/kush-eshte-i-informuar-eshte-i-shpetuar/>

- **Qëndro:** Nëse jeni poshtë një strehe si tavolina, mbahuni aty. Nëse jeni në ambient të hapur, largohuni nga ndërtesat dhe linjat elektrike.

